



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1766/24 Datë: 28/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I.** Akreditohet programi i studimeve i Kolegjit UBT dega në Ferizaj për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027):
 - *Shkenca Kompjuterike dhe Inxhineri BSc 180 (A) me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;*
- II.** Riakreditohen programet e studimeve të Kolegjit UBT dega në Ferizaj për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027):
 - *Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor BSc 180 (R) me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
- III.** Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV.** Obligohet Kolegji UBT dega në Ferizaj që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V.** Obligohet Kolegji UBT dega në Ferizaj të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI.** Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji UBT dega në Ferizaj brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin dhe riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Shkenca Kompjuterike dhe Inxhineri BSc 180 (A)</i>	Jakup Ratkoceri Ylber Limani Vehbi Neziri
2.	<i>Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor BSc 180 (R)</i>	Kreshnik Muhaxheri Egzon Bajraktari Nexhat Balaj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT dega në Ferizaj me ekipet në përbërje: Seifedine Kadry Maurizio Ferrari Dacrema, Lali Giorgidze, Philippe Bouillard, Ivana Milicevic dhe Nadia Manzoni

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Shkenca Kompjuterike dhe Inxhineri BSc 180***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 20.05.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Substancialisht gjashtë (6) dhe dhe Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor BSc 180***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 10.07.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht një (1) dhe Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Universum kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatim prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit UBT dega në Ferizaj;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë